



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Lulishtja Labi-A" Sh.P.K. të datës 19.08.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i Parqeve dhe Hapësirave Gjelbëruese" me nr. të prokurimit 616-25 7012-5-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Lulishtja Labi-A" Sh.P.K. të datës 19.08.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i Parqeve dhe Hapësirave Gjelbëruese" me nr. të prokurimit 616-25 7012-5-2-1.
- II. LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi** në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Lulishtja Labi-A" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 19.08.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i Parqeve dhe Hapësirave Gjelbëruese" me nr. të prokurimit 616-25 7012-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritot (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

“Nese i analizojmë specifikimet teknike të këtij tenderi, ne vërtetojmë se AK për këtë tender ka kërkuar furnizim e 81 produkteve të ndara ne tri grupe. Grupi i pare - Gjelbërim i larte produktet nga numri 1 deri 31. Grupi i dyte - Gjelbërim i mesëm, produktet nga numri 32 deri 75. Grupi i trete - Pune të tjera shtese, produktet nga numri 76 deri 81. Ekspertet tanë gjatë analizimit të DT-se, respektivisht pjesës se FDT-e neni 9.1&9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, kan gjetur se AK nuk ka vepruar ne përputhje me natyrën e këtij tenderi me rastin e vendosjes se kerkesave profesionale dhe kualifikimeve, si dhe nuk i ka korrigjuar ne mënyre të drejtë kërkesat e vendosura ne këtë nene respektivisht piken 3. Certifikimi, nënpika 4. ISO 39001-2012 – Sistemet e menaxhimit të sigurisë ne trafikun rrugor. Sepse, duke u bazuar ne DT- respektivisht Aneksi-1 – Specifikimet teknike, ne nuk gjejmë as një pozicion i cili lidhet me trafikun apo rregullimin e trafikut, për të cilin do të nevojitet një certifikim i tille”.

Përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese.

Pretendimet ankimore të parashtruesit janë shqyrtuar dhe me këtë rast është gjetur se këto pretendime janë të pabazuara në kuptim të kësaj kërkesë për rishqyrtim. Lidhur me pikën e parë ku parashtruesi ka ofruar një mendim personal mbi natyrën e pozicioneve në paramasë, në këtë pjesë parashtruesi nuk prezanton asnjë petitum përkatësisht nuk ka prezanton fare pretendim ankimor por vetëm një konstatim subjektiv pa kërkesë për ndryshim/plotësim të DT. Lidhur me këtë pikë AK njofton parashtruesin dhe të gjithë ofertuesit potencial se të gjitha pozicionet e paramasës duhet të realizohen saktësisht sikurse janë formuluar në paramasë të DT pa asnjë ndryshim gjatë fazës së realizimit të projektit. Ndërsa sa i përket pikës së dytë ku pretendohet se duhet të largohet certifikata ISO 39001-2012, kjo pikë po ashtu është e pabazuar sepse certifikata në fjalë është absolutisht e domosdoshme për të garantuar menaxhimin e sigurisë në trafikun rrugor dhe veçanërisht te pjesa e transportimit të mallrave dhe punonjësve nga lokacionet përkatëse deri te vendpunishtja dhe anasjelltas apo në situatat tjera kur kërkohet transportimi përmes trafikut rrugor.

Vlen të shtohet se AK tanimë e ka korrigjuar DT duke eliminuar përfundimisht të gjitha kërkesat për të cilat mund të dyshohen si diskriminuese.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 20.08.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.